


VEPRO ME KOHË



PËR NJË TË ARDHME MË TË MIRË

DEMOKRACIA, UDHËHEQJE E POPULLIT

ARBËR (13), AGNESA (13), ALBIONA (13), ENSAR (13), AGNESA (13), RINA (13), GENTIAN (13),
DIANA (13)



Të bashkëpunojmë me njëri-tjetrin, sepse vetëm të bashkuar shkojmë përpara. Respekti dhe toleranca është në mesin tonë

Disa fakte rreth demokracisë

Demokracia do të thotë udhëheqje e popullit. Fjala demokraci rrjedh nga fjalët greke, që „demos“ do të thotë popull dhe „kratia“ udhëheqje. Për herë të parë, kjo formë e qeverisjes u shfaq në Athinë, Greqi, në vitin 507 para erës sonë. Të drejtën e vendimmarrjes në atë kohë e kishin vetëm burrat e pasur, kurse gratë dhe skllëverit nuk e kishin këtë të drejtë. Gjë e cila sot ka ndryshuar, sepse tani i gjithë populli e ka të drejtën e vendimmarrjes.



Sa është e rëndësishme liria për ne ?

Më 17 shkurt 2008, Kosova u shpall shtet i pavarur dhe demokratik. Të parët tanë, vepruan dhe sakrifiku-an shumë për vendin tonë, që ne sot të jemi të lirë dhe të veprojmë lirshëm. Element kyç në demokraci është pikërisht liria dhe kjo është e garantuar me ligj. Përveç lirisë, në demokraci të garantuara me ligj i kemi edhe të drejtat tona, si: të drejtën e shkollimit, të drejtën e familjes, të drejtën e votës, të drejtën e strehimit, të drejtën e kujdesit shëndetësor, të drejtën e lojës, etj. Kemi shembuj të ndryshëm për sa i përket të drejtave tona. Nëse një qytetar dëshiron që të studioj mjekësinë, ai/ajo mund ta zgjedh atë drejtim, sepse e ka atë të drejtë. Po ashtu, të gjithë fëmijët e kanë të drejtën

të vijojnë mësimet në shkollë. Le ta paramendojmë se çdo të ndodhte sikur të mos i kishim këto të drejta. A thua çfarë do të ndodhte? Si do të ndjeheshim ne? A do të ishim të barabartë? Në një situatë të tillë, ne nuk do ta kishim lirinë dhe barazinë. Prandaj, nuk do të ndjeheshim aspak mirë, sepse nuk do të mund ta shprehnim mendimin tonë lirshëm, dhe do të ishim ndjerë sikurse zogu i mbyllur në kafaz. Element tjetër i demokracisë është edhe e drejta për të zgjedhur, që nënkupton të drejtën për të votuar. Në procesin zgjedhor, kur bëhet zgjedhja e përfaqësuesve të vendit, marrin pjesë të gjithë ata të cilët janë 18 vjeç e tutje, pa dallim gjinie dhe race. Por, pse ndodh kjo? Për arsye se të gjithë jemi të barabartë ngase ne jetojmë në një vend demokratik ashtu siç edhe e përmendëm më herët.



Qytetarët e rinjë




Në këto dy vizatime kemi paraqitur shenjat e komunikacionit. Duke pasur parasysh që ligjet rregullojnë jetën tonë, në mënyrë që ne të kemi një jetë sa më të mirë, ato duhen të respektohen dhe të zbatohen nga të gjithë qytetarët



Respekti dhe mirëkuptimi për njëri-tjetrin, bëjnë që ne të jetojmë një jetë paqësore



Para se të marrim vendime duhet të mendo kemi mirë dhe të hulumtojmë rreth gjërave që na interesojnë



Demokracia, formë e qeverisjes në të cilën të gjithë e kanë të drejtën e vendimmarrjes

LIGJET MIRATOHEN PËR MIRËQENIEN TONË

ALBERINA (13), LUMBARDH (13), SUMEA (13), ALBAN (14), YLLGZONA (13), RINOR (13), FLANDRA (13),
RIAD (13)

Institucioni i Kuvendit është institucion i miratimit të ligjeve

Biblioteka, kinemaja, teatri, janë këto vende ku të rinjtë pasurohen me dije dhe informata të reja, e që fatkeqësisht nuk janë të pranishme në komunën tonë, e cila është Vitia.

Ne si qytetarë të komunës së Vitisë, do të bëjmë një kërkesë të hapur drejtuar përfaqësuesve të shtetit, që të marrin masa dhe të sigurojnë që të gjitha komunat e Kosovës të jenë të pajisura me objektet e lartcekura. Ne kemi shumë të rinjë, të cilët janë të talentuar për aktrim e që nuk kanë edhe shumë hapësirë që ta shprehin atë. Teatri do të ishte një vend i përkryer për ta. Kurse, biblioteka do të ishte vend i përkryer për të

lexuar librat. Siç edhe e dijmë, Kosova është shtet i ri demokratik, gati që 10 vjet. Në Kosovë, vazhdimisht po miratohen ligje të reja, e deputetët janë ata të cilët i miratojnë ato. Ne si qytetarë, prej moshës 18 vjeçare, mund të marrim pjesë në procesin zgjedhor dhe aty do ti zgjedhim deputetët të cilët do të na përfaqësojnë neve në Kuvend. Deputetët e zgjedhur, e zgjedhin Presidentin e shtetit, kabinetin qeveritar, etj. Deputetët mbajnë seanca plenare pothuajse çdo të enjte dhe aty iu kërkojnë llogari ministrave të Qeverisë. Nëse Qeveria nuk e bën punën mirë, atëherë deputetët kanë të drejtë të propozojnë mocion mosbesimi ndaj saj. Por, kjo ndodh vetëm nëse shumica e deputetëve votojnë pro këtij mocioni, e atëherë mund të kemi rënien e Qeverisë. Kështu që, duhet të organizohen zgjedhje të reja.


Rëndësia e njohjes së institucioneve të shtetit është shumë e rëndësishme. E sidomos njohja e Kuvendit të Kosovës, sepse pikërisht prej këtij institucioni fillon dhe zhvillohet demokracia. Kuvendi ka gjithsej 120 deputetë. Përveç përfaqësuesve shqiptarë, në Kuvend ka edhe deputetë të cilët u takojnë komuniteteve jo shumicë. E kjo e bën Kosovën tonë shembull i një shteti demokratik. Hapat e një ndryshimi pozitiv, vijnë nga ne. Prandaj ne duhet t'i njohim të drejtat tona dhe t'i shfrytëzojmë ato, sepse vetëm kështu e forcojmë demokracinë.



Gazetarët e institucionit më të lartë të Kosovës



Ligjet bëhen me qëllim të rregullimit të jetës sonë



Vendosja e drejtësisë në vend është mjaft e rëndësishme

MENDJA DHE DUART QË BËJNË NDRYSHIME

BLERON (14), VERONA (13), SARA (14), VESA (14), ARTIOLA (13), EUGERTA (13), ARDIT (13), FATOS (13)



Të fillosh një iniciativë, paraprakisht duhet të kesh ide. Kjo i bie se ne duhet të aktivizojmë mendjen dhe duart tona për të bërë ndryshime

Mendja jonë ka fuqi të madhe për të propozuar ide të ndryshme dhe efektive për të gjithë ne. Me këtë nënkuptojmë se përveç se duhet të japim ide të mira, ato duhet t'i vëmë në funksion. Por kush janë personat të cilët i vënë në funksion idetë e tyre? Këta persona njihen si qytetarë aktiv dhe karakterizohen me vullne-

dhe duke i zbatuar me përpikëri elementet bazike të demokracisë. Të fillë, pra qytetarë aktiv, ndjehemi edhe ne nxënësit që e kemi shkruar këtë artikull për ju. Këtë fakt e mbështesim në punët tona vullnetare që i kemi bërë deri më tash. Si p.sh., kemi pastruar rrugët e fshatit tonë, kemi ndihmuar njerëzit në nevojë, si dhe kemi organizuar programe të ndryshme festive me karakter edukativ për të gjithë nxënësit e shkollës. Ne duam të ndalemi tek kjo e fundit, sepse kemi parë se si një aktivizim i vogël bën ndryshime të mëdha si në mendjet e nxënësve, ashtu edhe në aktivizimin dhe përfshirjen e tyre. Prandaj, qytetarë të dashur, ne kemi mundësi të marrim shembuj të ndryshëm nga mjetet e ndryshme informuese dhe të shikojmë punët që i bëjnë qytetarët aktiv. Kjo i bie se edhe ne më vonë do të bëhemi model për të tjerët se si veprojnë qytetarët aktiv. Andaj, shoku ynë Bleroni e ka një pyetje dhe një mesazh për ju: „Çfarë jeni duke pritur?, bëhuni edhe ju qytetarë aktiv.“




Me duart tona bëjmë mrekulli

tin e madh për të bërë ndryshime pozitive në vend. E tërë kjo rrjedh nga shpirti human që ata e kanë. Këta qytetarë, pothuajse çdo herë veprimeve të tyre iu paraprijnë me plane afatgjate dhe efektive për të gjithë qytetarët e komunitetit ku ata jetojnë. Mënyra se si ata e bëjnë këtë është duke marrë pjesë në organizata jo-qeveritare, duke krijuar grupe të ndryshme punuese, duke bërë punë vullnetare, duke dalur për të votuar



Ndajmë përgjegjësi për vendin tonë



IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë: Pjesëmarrësit:
Tel: +381 38 704 560 SHFMU „Dëshmorët e 5 Prillit“
E-mail: info@demos-ti.org Klasa: VIII
Website: www.demos-ti.org Vendi: Viti